



VENDIM NR.4
DATË 31 .07.2023
I ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË AKSIONARËVE

Sot, më datë 31.07.2023, ora 12:00, në adresën: Lagjja “16 Prilli”, Fier, u mbajt mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të shoqërisë “F.K. Apollonia”sha. Në këtë mbledhje janë të pranishëm të gjithë aksionarët e shoqërisë dhe konkretisht:

- Aksionari, Bashkia Fier, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë, Z. Armando Subashi;
- Aksionari Z. Koço Kokëdhima.

Mbledhja zhvillohet duke respektuar kuorumin e përfaqësimit, pasi janë të pranishëm të gjithë aksionarët. Sipas njoftimit dt. 07.07.2023 të Administratores së shoqërisë, kjo mbledhje Asambleje ishte planifikuar më datë 20.07.2023, ora 12:00, por, duke qenë se për shkak të mungesës së aksionarëve, kjo mbledhje nuk u zhvillua, me miratimin e të dy aksionarëve, kjo mbledhje po zhvillohet sot, me të njëjtin rend dite, të njoftuar sipas Njoftimit 07.07.2023. Në bazë të nenit 144 dhe 145 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, mbledhja konsiderohet e rregullt.

Rendi i ditës së mbledhjes është si më poshtë vijon:

1. Të propozohet miratimi i raportit të zmadhimit të kapitalit të shoqërisë “F.K. Apollonia”sha, përgatitur nga eksperti kontabël i regjistruar Bujar Rami, me NUIS L21501047E, si rrjedhojë e kontributeve në para të derdhura nga aksionari Bashkia Fier, gjatë vitit 2022, duke saktësuar vlerën e kontributit që përfaqëson përqindja e çdo aksionari, vlerën e kapitalit të shlyer, vlerën e kapitalit në para dhe në natyrë për secilin aksionar.
2. Riemerimi ne detyren e anetareve të Këshillit Mbiqyrës të shoqërisë “F.K Apollonia”sha, të:
 - Z. Fredi Dervishi, për një afat 3 (tre) vjeçar, duke filluar nga data 02.09.2022;
 - Znj. Adela Hysenaj, për një afat 3 (tre) vjeçar, duke filluar nga data 02.09.2022.
3. Miratimin e bilancit vjetor të shoqërisë “F.K. Apollonia” sha për vitin 2022, sipas të cilit shoqëria rezulton me humbje në shumën 9,463,404 Lekë (nëntëmilion e katërqindë e gjashtëdhjetë e tre mijë e katërqind e katër). Humbja e rezultuar për vitin financiar 2022, të kalohet në humbjet e mbartura të shoqërisë.
4. Miratimin e raportit të auditimit të pasqyrave financiare të shoqërisë “F.K. Apollonia” sha për vitin 2022, përgatitur nga audituesit ligjor, Bujar Rami, me Licencë nr. 90, datë 07.12.2000, NUIS L21501047E dhe Engjëllushe Rami me Licencë nr. 259, datë 27.08.2012 dhe NUIS L32109025F.

Për sa më sipër, Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve, pasi diskutoi çështjet e përfshira në rendin e ditës, unanimisht, për pikën e parë të rendit të ditës, vendosi:





1. Të miratohet Raporti i Zmadhimit të Kapitalit të shoqërisë "F.K. Apollonia" sha, dt. 7.7.2023, përgatitur nga eksperti kontabël i regjistruar Bujar Rami, me NUIS L21501047E, si rrjedhojë e kontributeve në para të derdhura nga aksionari Bashkia Fier, në bazë të vendimit nr.3, date 02.09.2022 dhe vendimit nr. 1, dt. 21.03.2023 të Asamblese se Pergjithshme te Aksionareve, duke saktësuar, gjithashtu, vlerën e kontributit që përfaqëson përqindja e çdo aksionari, vlerën e kapitalit të shlyer, vlerën e kapitalit në para dhe në natyrë për secilin aksionar.

Bazuar në këtë raport, përpara realizimit të zmadhimit, numri i aksioneve respektive për çdo aksionar, përqindja e pjesëmarrjes për çdo aksionar, kontributi në vlerë para zmadhimit të kapitalit, ndarja e kontributeve në natyrë dhe në para, për çdo aksionar, para zmadhimit, është sipas Tabeles:

Nr	Aksioner	Numri aksioneve	Pjesëmarrja në përqindje	Pjesëmarrja në vlerë	Nga i cili :	
					Kontributi në natyrë	Kontributi në para
1	Bashkia Fier	313,194	33.80%	313,194,000	45,444,000	267,750,000
2	Koço Kokedhima	613,542	66.20%	613,542,000	222,092,000	391,450,000
	Shuma	926,736	100%	926,736,000	267,536,000	659,200,000

Pas zmadhimit të kapitalit me kontribute në para të aksionarit Bashkia Fier, në shumën totale 15,000,000 (pesëmbëdhjetë milion) Lekë, sipas vendimit nr.3, date 02.09.2022 dhe vendimit nr. 1, dt. 21.03.2023 të Asamblese se Pergjithshme te Aksionareve, kapitali i shoqërisë "F.K. Apollonia" sha bëhet 941,736,000 (nëntëqindë e dyzet e një milion e shtatëqindë e tridhjetë e gjashtë mijë) lekë, i ndarë në 941,736 (nëntëqindë e dyzet e një mijë e shtatëqindë e tridhjetë e gjashtë) aksione, me vlerë nominale 1,000 lekë secili.

Pas këtij zmadhimi:

- kapitali i nënshkruar i shoqërisë "F.K. Apollonia" sh.a. bëhet 941 736 000 leke.
- Vlera e kapitalit të shlyer i shoqërisë "F.K. Apollonia" sha, bëhet 941 736 000 leke.





Pas zmadhimit, numri i aksioneve, përqindja e pjesëmarrjes, kontributi në vlerë, ndarje e kontributit në natyrë dhe në para, për çdo aksionar, është sipas tabelës së mëposhtme:

Nr	Aksioner	Numri aksioneve	Pjesëmarrja në përqindje	Pjesëmarrja në vlerë	Nga i cili :	
					Kontributi në natyrë	Kontributi në para
1	Bashkia Fier	328,195	34.85%	328,194,996	45,444,000	282,750,996
2	Koço Kokëdhima	613,541	65.15%	613,541,004	222,092,000	391,449,004
	Shuma	941,736	100.00%	941,736,000	267,536,000	674,200,000

ASAMBLEJA E PËRGGJITHSHME E AKSIONARËVE TË SHOQËRISË
"F.K. APOLLONIA"SHA

BASHKIA FIER

Përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë

Z. Armando SUBASHI

Armando Subashi



Z. Koço KOKËDHIMA

Koço Kokëdhima

